REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.6.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR

TË MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Valbona Tolaj - Udhëheqëse ekipi), me anëtarët Hysen Boqolli dhe Abdurrahmon Berbatovci, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit - Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm....6

2 Qeverisja....10

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....16

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit....28

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....29

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak....32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit[1], të datës 13/12/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vertetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive jo-financiare dhe obligimeve të papaguara nuk janë plotësisht të besueshme dhe të sakta. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

[1] Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit "

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e pasurisë si dhe salldon e obligimeve.	Ministri t'i analizojë arsyet për përsëritjen e Theksimit të Çështjes edhe në vitin 2016 dhe të identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë dhe obligimeve në vitin 2017 (shih nënkapitullin 1.1).
Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 3 dhe 4).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet 5, 6 dhe 7).
Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin.	Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 11, 12, 14, 15 dhe 17).

Përgjigja e Ministrit

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive jo-financiare dhe obligimeve të papaguara nuk janë plotësisht të besueshme dhe të sakta, si:

- Pasuria në vlerë 1,758,177€ lidhur me Projektin për shtëpitë e personave të riatdhesuar nuk është larguar nga regjistri i pasurive edhe pas dorëzimit të shtëpive te përfituesit;
- Ministria ende nuk posedon një regjistër të plotë të të gjitha pronave të saj ujore (siç përcaktohet me Ligjin e Ujërave Nr. 04/L-147); dhe
- Obligimet e Ministrisë janë nënvlerësuar për 5,755,440€ sepse nuk ishte shpalosur obligimi i bazuar në Vendimin përfundimtar të Qeverisë nr. 06/104 për shpronësime. Sidoqoftë, kjo është raportuar në raportet e rregullta të obligimeve në vitin 2017.

Kjo reflekton mungesë të një sistemi efektiv të kontrolleve për menaxhimin e pasurive dhe trajtimin e obligimeve (llogarive të pagueshme). Opinioni ynë nuk është modifikuar (apo kualifikuar) për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Raportin Financiar Nëntëmujor;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit (MFK);
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€; dhe
- Draft Planin dhe Planin Përfundimtar i prokurimit.

Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 13/12/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar pjesërisht nga menaxhmenti.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe kemi dhënë disa sugjerime të tjera për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Në Raportin e ekzekutimit të buxhetit, hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit, buxheti final për grantet e përcaktuara të donatorëve (shënimi 12) ishte nënvlerësuar për 1,733,557€. Në anën tjetër, shuma e huamarrjes 782,000€ (shënimi 13) ishte raportuar te buxheti fillestar dhe final si dhe te realizimi duke shkaktuar mbivlerësim për tërë shumën. Pranimet/kthimet e huamarrjes menaxhohen dhe regjistrohen nga Ministria e Financave;
- Vlerat e regjistruara në SIMFK për depozitat në mirëbesim nuk janë harmonizuar me vlerën e parave në llogarinë bankare; dhe

- Në PVF nuk ishin bashkangjitur anekset për stoqet dhe pasuritë nën 1,000€.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e draft PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët. Në PVF-të finale Ministria ka korrigjuar gabimet e paraqitura në pikën e parë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, megjithëse janë identifikuara disa gabime të cilat janë shpalosur të theksimi i çështjes në nënkapitullin 1.2..

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë si në vijim:

- Raportet tremujore për projektet kapitale nuk ishin dorëzuar brenda afateve kohore në Ministrinë e Financave. Po ashtu cilësia e raporteve nuk ishte në nivelin e kërkuar; dhe
- MMPH në planifikimin përfundimtar të prokurimit kishte përfshirë kontratat të cilat ishin të nënshkruara para vitit 2016. Kjo kishte ndodhur për shkak të synimit për t'i raportuar vlerat e kontratave për t'u realizuar në vitin aktual. Për më tepër njoftimi paraprak për kontrata ishte bërë me vonesë më 30/06/2016.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për dy (2) çështjet e sipërpërmendura ne japim rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për përsëritjen e Theksimit të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në raportimin e obligimeve dhe për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë përfshirë afatet kohore dhe cilësinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, duhet të dorëzohet vetëm pas rishikimit detaj të PFV-ve nga menaxhmenti.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MMPH-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvillojë proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësori i vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MMPH-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësori i vetëvlerësimit, e plotësuar nga MMPH-ja, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), vendosja e objektivave dhe menaxhimi i rreziqeve nuk janë të vendosura plotësisht.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të MMPH-së ka rezultuar në 21 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) janë në proces të zbatimit, ndërsa 7 nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse MMPH nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në dobësi gjatë ekzekutimit të shpenzimeve si dhe efikasitet të ulët në realizimin e investimeve kapitale dhe aktiviteteve operative.
Rekomandimi 3	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme dhe aty ku rekomandimet janë përsëritur. Një monitorim sistematik nga ana e menaxhmentit është i nevojshëm për të siguruar zbatim efektiv të rekomandimeve dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MMPH-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për çështjet kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 – Pyetësori i vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar vetëm çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Pyetësori ishte plotësuar dhe reflekton gjendjen e Ministrisë në përgjithësi. Ndonëse Ministria ka shënuar progres në aranzhimet lidhur me vetëvlerësimin, për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësori i vetëvlerësimit i plotësuar nga MMPH-ja ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Edhe përkundër rekomandimit të vitit paraprak regjistri i rreziqeve nuk është hartuar. Kjo reflekton një mungesë të alokimit të përgjegjësisë për menaxhim të rrezikut;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse konsiderohen pjesërisht të vendosura nga MMPH-ja por dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të dobëta. Çështjet e monitorimit janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të pa vendosura nga MMPH.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MMPH-së që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha specifike të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MMPH operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar funksionimin e sistemeve financiare. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave operative të identifikuara.

MMPH ka dy agjenci vartëse: Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK) dhe Agjencionin për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës (AMMK). Për të siguruar një menaxhim financiar dhe raportim efektiv nevojitet një proces cilësor i konsolidimit dhe raportim me kohë.

Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura	Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të MMPH-së ka nxjerrë në pah një raportim jo adekuat financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në në realizimin e buxhetit dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operative nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
Rreziku	Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar mundësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e MMPH-së në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
Rekomandimi 5	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.

Çështja 6 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura MMPH është përgjegjëse për një sërë aktivitetesh në fushat kyçe në mbrojtjen e mjedisit, ujërave, rregullimin dhe zhvillimin e planifikimit hapësinor, kadastrin dhe shpronësimin në nivel nacional. Këto aktivitete MMPH i adreson përmes dy agjencive të saj. Ato kanë strukturën e tyre menaxhuese ndërsa AKK përgatit edhe PFV-të e veta. Për shkak se përgjegjësitë e raportimit në mes MMPH-së dhe Agjencive Ekzekutive të saj nuk janë përcaktuar qartë dhe nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, kjo ka rezultuar me procese të dobëta të llogaridhënies dhe konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare. Si pasojë e këtyre dobësive, në mars 2016, Kryeshefi i AMMK-së pa një vendim formal të Ministrit kishte decentralizuar prokurimin dhe certifikimin e pagesave përkundër që ky decentralizim nuk parashihej në strukturën organizative të ministrisë.

Rreziku Kërkesat jo adekuate të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët e reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda MMPH-së. Kjo rezulton në dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Në anën tjetër, decentralizimi i pakoordinuar i sistemeve mund të rezultojë me aktivitete dhe shpenzime potencialisht të parregullta.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë një rishikim të proceseve ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit nga agjencitë ekzekutive si dhe të vendos aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike deri më 1 tetor 2017. Të gjitha ndryshimet në strukturën organizative duhet të bëhen përmes proceseve formale dhe aprovimeve të kërkuara.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy (2) auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MMPH-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruara nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Gjatë vitit 2016, NjAB ka arritur të përfundoj pesë (5) prej gjashtë (6) auditimeve të planifikuara. Dy (2) auditime tjera shtesë janë realizuar me kërkesë të menaxhmentit. Dy (2) auditime kishin mbuluar periudhën 2015, dy (2) tjera periudhën 2015/2016 dhe tri (3) periudhën 2016.

Çështja 7 – Dobësitë në sistemin e Auditimit të Brendshëm - Prioriteti i lartë

E gjetura

Ekzistojnë një numër dobësish që ndërlidhen me operacionet aktuale të NjAB-së si:

- Për një (1) raport të auditimit të brendshëm nuk ishte përgatitur plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve;
- Sipas raportit të NjAB-së, vetëm 43 nga 62 rekomandimet e dhëna nga NjAB ishin zbatuar plotësisht nga menaxhmenti; dhe
- Ekziston një diferencë e theksuar ndërmjet pagave të auditorëve të brendshëm. Njëri auditor paguhet me koeficientin 16 ndërsa tjetri me koeficientin 7.

Rreziku

Dobësitë e identifikuara në sistemin e auditimit të brendshëm rezultojnë në mos adresimin e dobësive në kontrolle duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje potenciale financiare për MMPH-në. Mos adresimi i rekomandimeve do të përkeqësojë tutje situatën aktuale.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të sigurojë një komunikim efektiv me Komitetin e Auditimit për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe arsyet për dallimin në paga të auditorëve dhe adresimin e tyre. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket MMPH-se, prokurimi i projekteve te reja mbetet shqetësim i madh, për faktin qe kjo lidhet drejtpërdrejtë me projektet e vjetra, të stërzgjatura që ende nuk kanë përfunduar. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë pjesërisht funksionale duke përfshirë edhe faktin se të hyrat që mblidhen nga departamenti i ujërave të cilat edhe përkundër legjislacionit të ri sekondar arkëtimi i tyre mbetet sfidë. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar MMPH-në të pësojë humbje potenciale financiare dhe/apo vlerë të ulët për para. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë procesi i prokurimit dhe shpronësimet.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	0	0	609,575	686,399	616,742
Totali	**0**	**0**	**609,575**	**686,399**	**616,742**

Të hyrat vetjake në shumë 609,575€ janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK). Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një ulje të të hyrave për 13% (76,823€) krahasuar me vitin paraprak. Kjo ulje kryesisht është si rezultat i lëvizjeve të kërkesave për leje apo pëlqime mjedisore nga bizneset dhe individët.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**39,173,728**	**39,392,076**	**38,172,422**	**38,126,445**	**44,967,147**
Granti i Qeverisë - Buxheti	38,454,728	36,318,333	36,157,798	35,781,311	42,501,820
Huamarrja	719,000	782,000	720,076	1,756,619	1,945,368
Donacionet e jashtme		2,291,743	1,294,548	588,515	519,960

Buxheti final është për 218,348€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo rritje është rezultat i lëvizjeve të buxhetit për shkak të donacioneve të jashtme, rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, MMPH ka përdorur 97% të buxhet final ose 38,172,422€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2015.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**39,173,728**	**39,392,076**	**38,172,422**	**38,126,445**	**44,967,147**
Pagat dhe Mëditjet	2,138,187	2,077,548	1,984,177	1,817,788	1,613,389
Mallrat dhe Shërbimet	1,118,081	1,923,072	1,358,734	1,510,329	1,607,834
Shërbimet komunale	83,220	55,504	40,974	41,702	48,063
Subvencionet dhe Transferet	190,000	0	0	-	-
Investimet Kapitale	35,644,240	35,335,952	34,788,537	34,756,626	41,697,861

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 69,639€ si kursime buxhetore. Kjo ka ndodhur për shkak se numri i aprovuar i stafit ishte 335 ndërsa numri i stafit gjatë vitit ishte 317 (18 më pak);
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 804,991€. Fillimisht ishte rritur si rezultat i donacioneve prej 990,484€, si dhe transfereve nga subvencionet prej 25,000€. Ndërsa në anën tjetër ishte reduktuar për 76,145€ me proces të rishikimit të buxhetit dhe për 134,348€ me vendimet e Qeverisë;
- Buxheti për subvencione dhe transfere fillimisht ishte reduktuar për shkak të transferit prej 25,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në fund i tërë buxheti i mbetur ishte reduktuar me vendim të Qeverisë; dhe

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti për investime kapitale ishte reduktuar për 308,288€. Fillimisht ishte rritur për 2,341,364€ (1,352,115€ si rezultat i donacioneve, 259,444€ me rishikim të buxhetit dhe 729,805€ me vendimet e Qeverisë), mirëpo në fund të viti kishte pësuar shkurtime buxhetore me vendim të Qeverisë në vlerë 2,586,652€ dhe ishin transferuar në kategori tjetër të shpenzimeve 63,000€.

Fondet e pranuara nga donatorët në shumë 2,291,743€ ishin alokuar në kategori të ndryshme të shpenzimeve.

Çështja 8 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i mesëm

E gjetura Edhe pse realizimi i përgjithshëm i buxhetit kishte arritur 97%, procesi i menaxhimit të buxhetit përgjatë vitit nuk ishte administruar në mënyrë efektive, në veçanti duke pasur parasysh obligimet e raportuara në fund të vitit. Një realizim tejet i ulët ishte paraqitur te buxheti nga donacionet ku vetëm 56% të fondeve ishin shpenzuar. Kjo kishte ndodhur për shkak që një donacion ishte pranuar me 15/12/2016.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi joefektiv i tij rezulton në mos arritjen e objektivave të organizatës. Niveli i ulët i shpenzimit të fondeve të donatorëve mund të rezultojë me humbje apo reduktim të donacioneve në periudhat e ardhshme.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final dhe në planifikimet për vitet e ardhshme.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MMPH në 2016 ishin në vlerë 609,575€. Ato kanë të bëjnë me licencat dhe/apo shërbimet e ndryshme që ofrohen nga kjo Ministri kryesisht përmes Departamentit të Ujërave (DU), Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit (DMM), Departamentit të Banimit (DPHNB) dhe AKK-së.

Çështja 9 – Dobësitë në menaxhimin e të hyrave – Prioritet i mesëm

E gjetura	Auditimi ynë në sistemin e menaxhimit të të hyrave ka identifikuar se Të hyrat nga shitja dhe pastrimet sanitare të pyjeve publike si dhe licencat për pëlqimet mjedisore dhe lejet ujore regjistrohen në një kod të vetëm ekonomik 50201 - Licencat për aktivitete individuale dhe të lira. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kodeve në SIMFK.
Rreziku	Regjistrimi i të hyrave të ndryshme në një kod ekonomik paraqet pasqyrim jo të qartë të të hyrave si dhe vështirëson monitorimin dhe vendimmarrjet e duhura nga ana e menaxhmentit.
Rekomandimi 9	Ministri duhet t'i forcojë kontrollet në menaxhimin e të hyrave për të siguruar që të gjitha të hyrat regjistrohen në kode adekuate në SIMFK në pajtim të plotë me planin kontabël dhe me Rregullën Financiare 03/2010 për të hyrat.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në nivel të Ministrisë janë autorizimi i listës së pagave, ndryshimi i listës së pagave dhe reflektimi i ndryshimeve të ndodhura.

Rekomandimet e pazbatuara nga viti paraprak mund të shihen në Shtojcën III të këtij raporti.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 1,358,734€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,984,177€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet operative si udhëtimi, qiraja, mallrat dhe shërbimet e ndryshme, si dhe shpenzimet komunale.

Çështja 10 – Papajtueshmëria me ligjet tatimore - Prioritet i mesëm

E gjetura Ligji[3] përcakton që punëdhënësi, në këtë rast MMPH, duhet të mbajë në burim tatimin në të ardhurat personale për pagesat për shërbimet profesionale. Testimi ynë ka identifikuar që MMPH nuk e kishte mbajtur tatimin në burim dhe kontributin pensional për pagesat për shërbimet profesionale ndonëse vlera e pagesave për këto shërbime gjatë vitit 2016 ishte 33,159€.

Rreziku Mos mbajtja në burim e tatimit dhe i kontributeve pensionale shpie në papajtueshmëri ligjore dhe humbje financiare për Buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kërkesat ligjore për tatimet në të ardhurat personale zbatohen në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për të përmbushur obligimet e MMPH-së si punëdhënës.

Çështja 11 - Dobësitë në prokurim për mallra dhe shërbime – Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar që kontrollet mbi prokurimin për mallra dhe shërbime në disa raste nuk kanë qenë efektive. Kjo ka rezultuar me papajtueshmëritë e paraqitura në vijim:

- Në procesin e prokurimit "Furnizim me tonerë" në vlerë 44,953€, nuk ekziston vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës ndërsa vendimi për komisionin e pranimit të mallrave ishte bërë me vonesë. Për më tepër, mallrat e pranuara nuk ishin në harmoni me specifikacionin sepse nuk ishin origjinale por "kompatibile" e që përjashtohej me dosjen e tenderit ndonëse kjo është në kundërshtim me kërkesat ligjore; dhe

- Te kontrata "Shërbime të përkthimit me shkrim dhe simultant" në vlerë 8,641€ ishte kërkuar që dëshmitë mbi mundësitë teknike profesionale (diploma dhe aktvendimi i gjykatës si përkthyes) të jenë origjinale ose të noterizuara. Ne kemi gjetur që në dosjen e tenderit mungonin këto dokumente sepse, sipas zyrtarëve, OE i kishte tërhequr për nevoja tjera.

[3] LIGJI NR. 05/L-028 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE, Neni 38

Këto të gjetura e theksojnë mungesën e rishikimit kritik të rezultateve të procesit të tenderimit që do të mundësonte identifikimin dhe adresimin e zbatimit adekuat të ligjit të prokurimit.

Rreziku Dobësitë e identifikuara në procesin e prokurimit çojnë në papajtueshmëri me kërkesa ligjore dhe vlerë të dobët për paranë e shpenzuar si dhe mund të rezultojnë me shpenzime potencialisht të parregullta.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit për mallra dhe shërbime nuk janë zbatuar dhe t'i forcojë kontrollet e prokurimit për të siguruar pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe vlerë të duhur për paranë e shpenzuar.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 35,335,952€. Prej tyre në vitin 2016 ishin shpenzuar 34,788,537€ (98%). Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime kapitale për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ambientit dhe shpenzimet për shpronësime.

Menaxhmenti ka vendosur një sistem të kontrollit për investimet kapitale duke përfshirë procesin e prokurimit dhe pagesave. Testimet tona kanë identifikuar që këto kontrolle nuk ishin efektive gjatë tërë periudhës. Dobësitë e identifikuara janë prezantuar në vazhdim.

Çështja 12 – Dobësitë në prokurim për investime kapitale – Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në procedurat e prokurimit, si:

- Në dosjen e tenderit "Faza e III - Rregullimi i lumit Drenica dhe Verbovc–Drenas" në vlerë 689,926€, operatori fitues nuk kishte përmbushur plotësisht kriteret mbi mundësitë teknike dhe profesionale lidhur me dorëzimin e listës së punëtorëve (minimum 20) dhe kopjet e kontratave të jenë identike me origjinalin;

- Në pagesën e situacionit në vlerë 108,353€ për projektin "Ujësjellësi i nëntë fshatrave te Kaçanikut" nuk ishte ndalur mbajtja e parasë e paraparë me kushtet e veçanta të kontratës në vlerë 10,835€ (10% të vlerës së situacionit); dhe

- Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për rregullimin e shtratit të lumit Drenica në Drenas – Faza e dytë ishte pranuar nga koordinatori i projekteve e jo nga një komision profesional i pranimit i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm. Për më tepër, hartimi i planit kryesor ishte bërë me vonesë.

Rreziku Shpërblimi me kontratë i operatorëve që nuk plotësojnë të gjitha kriteret shpie në papajtueshmëri ligjore, mund të jetë subjekt i trajtimit jo të barabartë të tenderuesve dhe mund të rezultojë me pamundësi për të ofruar punët e kontraktuara. Mos mbajtja e parasë dhe pranimi i projekteve nga një zyrtar i vetëm përveç që paraqet papajtueshmëri ligjore mund të rezultojë me kualitet të ulët të punëve dhe humbje potenciale financiare për Ministrinë.

Rekomandimi 12 Ministri duhet ta rishikojë dizajnin e kontrolleve për investimet kapitale dhe t'i forcojë ato për të siguruar pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore të prokurimit dhe pagesave. Të gjitha projektet duhet të pranohen nga komisionet profesionale dhe duhet të zbatohen mbajtja e parasë për të parandaluar cilësi të ulët të punëve dhe humbjet potenciale financiare..

Çështja 13 – Planifikimi dhe menaxhimi i projekteve – Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve për vitin 2016. Dobësitë e identifikuara ishin:

- Për projektin "Ndërtimi i Liqenit Akumulues në Lumin Ibër" në Mitrovicë, MMPH kishte kontratë në vlerë të 2,848,212€. Për shkak të projektimeve jo adekuate dhe specifikimeve teknike të pa qarta, për këtë kontratë ishin lidhur dy aneks kontrata në vlerë prej 77,645€ respektivisht 198,373€. Për punë shtesë në projektin e njëjtë MMPH kishte lidhur edhe një kontratë me një operator tjetër në vlerë 948,639€ si dhe një aneks kontratë në vlerë totale 275,837€. Për më tepër, aneks kontratat e lidhura nuk e specifikojnë vlerën e kontratës bazë;

- Për projektin "Baza e parë e ilegales së UÇK-së në Lladovc" Ministria kishte një kontratë në vlerë 999,621€ dhe një aneks kontratë në vlerë 94,359€. Për projektin e njëjtë ishin lidhur edhe dy kontrata tjera për punë shtesë në vlerë totale 19,840€; dhe

- Për kompleksin memorial "Beteja e Koshares" Ministria kishte një kontratë në vlerë 411,867€. Për projektin e njëjtë ishte lidhur një kontratë tjetër për vazhdim të punimeve në vlerë 177,304€.

Rreziku Menaxhimi respektivisht realizimi jo efektiv i projekteve kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave vjetore dhe strategjike të ministrisë dhe/apo pamundësinë e mbulimit të detyrimeve me fondet aktuale. Për më tepër, këto dobësi mund të rezultojnë me pagesa potencialisht të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve i nënshtrohet një analize reale të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare dhe kërkesat ligjore. Kontrollet në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuara me qëllim të arritjes së objektivave të ministrisë brenda afateve kohore dhe fondeve të planifikuara. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar një menaxhim adekuat të progresit financiar dhe fizik të projekteve kapitale.

3.1.5 Pagesat për shpronësim

MMPH është përgjegjëse për procesin e shpronësimit të pronave. Shpenzimet e shpronësimit bëhen nga buxheti për investime kapitale. Procedurat e regjistrimit të pronave të shpronësuara janë të rregulluara me Ligjin Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (i ndryshuar/plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-2015). Të gjitha të dhënat e shpronësimit si vlerësimi, kompensimi dhe regjistrimi pronave te paluajtshme duhet të regjistrohen në Sistemin Elektronik të Shpronësimit (SESh).

Testimet tona kanë identifikuar që procesi i shpronësimit është përcjellë me sfida të ndryshme për shkak të kontrolleve joefektive në rastet e paraqitura në vazhdim.

Çështja 14 – Menaxhimi i procesit të shpronësimeve - Prioritet i lartë

E gjetura Dobësitë në menaxhimin e procesit të shpronësimeve, janë shpalosur në vijim:

- Edhe pse Sekretari i Përgjithshëm kishte formuar një grup punues për hartimin e udhëzuesit operativ për SESh, ky udhëzues ende nuk është finalizuar. Si pasojë, procesi i shpronësimit ende bëhet në mënyrë manuale (në Excel). Po ashtu Ministria nuk ka një procedurë formale që rregullon funksionimin e brendshëm të procesit dhe që siguron ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarëve;

- Në 11 nga 13 mostra të testuara kemi identifikuar që parcelat e shpronësuara nuk janë regjistruar në Sistemin e Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë (SIKTK). Po ashtu, një numër i konsiderueshëm i lëndëve për t'u regjistruar ishin refuzuar nga Zyrat Komunale Kadastrale për shkak që elaboratet e shpronësimit nuk kishin plotësuar kërkesat e UA 18/2015[4]; dhe

[4] Udhëzimi Administrativ Nr 18/2015 për regjistrimin e shpronësimit të pronës së paluajtshme

- Në kuadër të AKK-së është zhvilluar projekti i Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale (RIK) në 20 zona kadastrale. Në katër prej këtyre zonave kishte filluar procesi i shpronësimit. Nga 1,724 lëndë të shpronësimit që ishin procesuar nga ky projekt, 1,224 (71%) prej tyre nuk i kishin plotësuar kushtet teknike dhe ligjore për regjistrim për shkak të gabimeve në elaboratet e shpronësimeve.

Rreziku Regjistrimi i të dhënave të shpronësimit në forma të Excel-it dhe mungesa e një procedure për këtë proces rritë rrezikun e gabimeve dhe redukton kualitetin e të dhënave të nevojshme për regjistrim dhe/apo për nevojat e menaxhmentit. Për më tepër, mundësia e ndryshimeve pa gjurmë (në Excel) dhe mungesa e plotë e regjistrimeve mund të jetë subjekt i ndryshimeve të papërgjegjshme dhe kompensimeve të dyfishta.

Rekomandimi 14 Ministri duhet t'i shqyrtojë arsyet e mos përfundimit të udhëzuesit operativ për përdorimin e SESh-it dhe paraqitjes së gabimeve në elaboratet e shpronësimit për të identifikuar veprimet e nevojshme për adresimin e tyre. Udhëzuesi operativ dhe procedurat për procesin e shpronësimit duhet të finalizohen dhe zbatohen deri më 1 tetor 2017. Njëkohësisht, duhet të hartohet një plan-veprimi për të siguruar që të gjitha gabimet në elaboratet e shpronësimet do të eliminohen dhe të njëjtat do të regjistrohen në sistem për të parandaluar kompensimet e dyfishta dhe humbjet potenciale financiare të Ministrisë.

Çështja 15 - Ekzekutimi i pagesave për shpronësime - Prioritet i lartë

E gjetura Ministria nuk kishte arritur të siguroj kontrolle në procesin e menaxhimit të pagesave. Dobësitë në menaxhimin e tyre i kemi shpalosur në vijim:

- Ministria kishte ekzekutuar një pagesë për shpronësim të pronës së një institucioni (jo-shtetror) në vlerë 265,720€ në një llogari private. Kjo kishte ndodhur pas kërkesës dhe autorizimit nga kreu i institucionit që pagesa të ekzekutohej në llogarinë private të njërit prej arkëtarëve të këtij institucioni; dhe

- Për shkak të vonesave në përfundimin e pagesave për shpronësime nga Ministria, Thesari kishte ekzekutuar pagesa bazuar në vendimet e gjykatave dhe përmbarimet në vlerë 1,793,057€. Testimet tona kanë identifikuar dy raste ku për shkak të vonesave, Ministria ka paguar 100,773€ shpenzime shtesë (për procedura të përmbarimit 18,739€, për kamatë 79,668€, dhe shpenzime tjera administrative 2,366€).

Rreziku Pagesa e mjeteve në llogari private është në kundërshtim me rregullat financiare dhe mund të rezultojë me shpenzime të parregullta. Ekzekutimi i pagesave nga Thesari dhe pagesave shtesë rezulton me reduktim të fondeve për operacionet vjetore dhe me dështim të arritjes së objektivave të Ministrisë.

Rekomandimi 15 Ministri duhet t'i forcojë kontrollet lidhur me ekzekutimin e pagesave për të siguruar që të gjitha pagesat bëhen në pajtim të plotë me rregullat financiare në fuqi. Arsyet për vonesa duhet të identifikohen dhe të adresohen për të parandaluar ekzekutimin e pagesave nga procedurat gjyqësore/përmbarimore që mund të rezultojnë me shpenzime shtesë për Ministrinë.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 16 - Moszbatimi i penaleve – Prioritet i mesëm

E gjetura Testimet tona kanë identifikuar disa raste kur Ministria nuk kishte zbatuar penalet përkundër vonesave të operatorëve në përfundimin e punëve. Rastet e identifikuara ishin:

- Në kontratën "Ndërtimi i liqenit Akumulues në lumin Ibër" në vlerë 2,848,212€, deri tek situacioni i XVII-të, kishte vonesë për 654 ditë pune. Vlera e ndëshkimeve të pazbatuara (5/1000 ditë dhe max. 10% të vlerës së kontratës) në këtë rast arrinte 284,821€; dhe
- Në kontratën "Hartimi i Anex Elaboratit për shpronësimin e Pronave për nevojat e ndërtimit të Memorialit Baza e I-rë" në vlerë 4,453€ kishte vonesë për 130 ditë. Vlera e ndëshkimeve të pazbatuara në këtë rast arrinte 445€.

Rreziku Moszbatimi i penaleve për vonesa në realizimin e punëve rezulton në vonesa të vazhdueshme në arritjen e planeve të përcaktuara të Ministrisë. Për më tepër, përveç që është papajtueshmëri ligjore, këto raste motivojnë operatorët për vonesa tjera dhe shkaktojnë humbje financiare për Buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 16 Ministri duhet t'i forcojë kontrollet financiare dhe të prokurimit në menaxhimin e kontratave gjegjësisht në respektimin e afateve kohore. Në rastet e vonesave duhet të zbatohen të gjitha ndëshkimet në pajtueshmëri të plotë me kushtet e kontratës.

Çështja 17 - Pranimi i furnizimeve – Prioritet i lartë

E gjetura Në dy raste ne identifikuam se nuk kishte kontrolle adekuate në pranimin e mallrave. Këto janë shpalosur në vijim:

- Furnizimi me pajisje kompjuterike në vlerë 472,255€ nga Granti i Bankës Botërore ishte bërë vetëm nga zyrtari i pranimit e jo nga komisioni për pranim që ishte emëruar nga Kryeshefi i AKK-së; dhe
- Te furnizimi me toner në vlerë 1,220€ mungonte raporti i pranimit nga komisioni siç e parasheh Rregullorja e Financiare 01/2013/MF – shpenzimi i parave publike.

Rreziku Pranimi i furnizimeve nga vetëm një person dhe mungesa e raportit të pranimit paraqet papajtueshmëri me rregullat financiare dhe mund të rezultojë me cilësi/sasi jo adekuate dhe me vlerë të ulët për para. Pagesat në këso rrethana mund të rezultojnë me shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha pranimet e mallrave dhe shërbimeve kryhen përmes komisioneve të emëruara nga menaxhmenti për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e duhur kundrejt vlerës për paranë e paguar dhe për të siguruar pajtueshmëri të plotë me kërkesat e rregullave financiare.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë kapitale përfaqësojnë pasuritë mbi 1,000€ ndërsa ato jo-kapitale pasuritë nën 1,000€. Vlera neto e pasurive në PVF 2016 është 192,069,275€. Një sistem i mirëfilltë i menaxhimit të pasurive kërkon përcaktim të qartë të rrjedhës së detyrave për regjistrimin, krahasimin, raportimin dhe shpalosjen e tyre në pasqyra financiare.

Përderisa çështjet lidhur me vlerën e raportuar të pasurive janë trajtuar në nënapitullin 1.2 të këtij raporti, çështjet tjera janë prezantuar në vazhdim.

Çështja 18 - Përdorimi i pasurive – Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar disa papajtueshmëri lidhur me përdorimin e pasurive të Ministrisë si në vijim:

- Disa ish zyrtarë të cilëve ju ka skaduar mandati nuk kishin kthyer pasurinë e Ministrisë me të cilën kanë qenë të ngarkuar (laptop dhe aparata digjital); dhe
- 11 automjete zyrtare ishin përdorur nga zyrtarët e Ministrisë pas orarit zyrtar në kundërshtim me Vendimin 12/2015 të Ministrit për përdorim të automjeteve jashtë orarit zyrtar të punës.

Rreziku Mos kthimi dhe/apo përdorimi i pasurive të Ministrisë pa autorizimet relevante përbën shkelje të procedurave ligjore dhe rezulton me keqpërdorim respektivisht me dëmtim apo humbje të pasurive publike.

Rekomandimi 18 Ministri duhet t'i analizojë arsyet që kanë shkaktuar moskthimin e pasurive dhe/apo përdorimin e tyre pa autorizimet relevante. Kontrollet duhet të forcohen për të siguruar zbatimin e plotë të akteve ligjore për përdorimin e pasurisë. Ministri duhet t'i iniciojë procedurat administrative dhe/apo gjyqësore për pasuritë e pakthyera dhe të siguroj që ato të kthehen deri më 1 tetor 2017.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në PVF-të e vitit 2016 ishte 986,055€ që reflekton një ngritje të këtyre llogarive për 28,217€ në krahasim me periudhën paraprake. Këto llogari rrjedhin nga taksat që duhet të paguajnë operatorët ekonomik që kryesisht janë shfrytëzues të ujit. Ministria ka ndërmarrë veprime administrative dhe gjyqësore për inkasimin e këtyre llogarive por realizimi i tyre mbetet një sfidë e vazhdueshme.

Rekomandimet

Nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Sipas PVF-ve të vitit 2016 obligimet e Ministrisë në fund të vitit ishin 150,038,276€ apo 4,038,276€ më shumë se në periudhën paraprake. Në strukturën e obligimeve bëjnë pjesë: vendimet përfundimtare të shpronësimit në vlerë 149,676,926€, investimet kapitale në vlerë 228,372, mallrat dhe shërbimet në vlerë 129,161€ dhe shpenzimet komunale në vlerë 3,817€.

Ngritja e vazhdueshme e vlerës së obligimeve paraqet sfidë serioze operative dhe buxhetore për periudhat e ardhshme të Ministrisë. Nënvlerësimi i këtyre obligimeve në PVF 2016-ve është trajtuar në theksimin e çështjes te opinioni i auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose

individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një

paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		MMPH ka treguar përkushtim në zbatimin e rekomandimeve, mirëpo mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Ekziston një progres në plotësimin e pyetësorit por kërkohen përmirësime në disa komponente.	Nuk janë marrë masa.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek zyrtarët përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet e bëra të regjistrohen në kategori adekuate më qëllim të prezantimit të drejtë të shpenzimeve të ndodhura. Për më tepër gjatë planifikimit buxhetor të konsideroj kërkesat për buxhet edhe në kategorinë e subvencioneve, me qëllim të identifikimit të saktë të shpenzimeve.	Po		

3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroje që rregullat mbi njoftimin paraprak të kontratave janë aplikuar me qëllim të reklamimit, transparencës dhe konkurrencës së mirëfilltë të procesit.		Njoftimet paraprake për procedurat e planifikuara të prokurimit ishin bërë, megjithëse kishte vonesa në këto procese.	
3.4 Prokurimi	Para çdo fillimi te projektit Ministri duhet të siguroj që Ministria paraprakisht është pajisur me leje ndërtimi sidomos kur behet fjalë për projekte të kategorisë së tretë.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj një rishikim të hollësishëm pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar për të gjitha prokurimet dhe të identifikojnë masat e duhura për të siguruar që këto dobësi të identifikuara janë adresuar në mënyrë efektive.	Po		
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj që më rastin e nënshkrimit të kontratave në të cilat aplikohet çmimi për njësi të bëhet edhe planifikimi i përafërt i sasive. Kjo do e mundësoj një pasqyrë më gjithëpërfshirëse lidhur me shpenzimet e kontraktuara.	Po		
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të ushtrojë kontrolle shtesë për të siguruar që procedurat kanë filluar me kohë dhe për çdo projekt të filluar paraprakisht të sigurohen mjetet financiare në përputhje me planin dinamik të realizimit të punëve.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve financiare rreth regjistrimit të faturave në SIMFK për të siguruar futjen e të dhënave të sakta në sistem.	Po		
3.5.2 Pagesat për shpronësim	Ministri duhet te siguroj aplikimin e sistemit aktual të SESH-it në një periudhë sa më të shkurtër kohore në mënyrë që të marrë siguri më të madhe për menaxhimin e procesit të shpronësimit përfshirë realizimin e shpenzimeve për shpronësim.		MMPH ka ndërmarrë veprime por SESH ende nuk është në përdorim.	

3.5.2 Pagesat për shpronësim	Ministri duhet të siguroj që kompensimi i pronave të shpronësuara paguhet sipas afateve kohore në përputhje me ligjin dhe vendimet përkatëse të qeverisë, si dhe realizimi i tyre të bëhet në mënyrë kronologjike bazuar në aplikimet e palëve.		Në disa raste ishin aplikuar kamata për vonesa ne pagesën e shpronësimit. Sidoqoftë, ende ekzistojnë disa sfida në këtë proces.	
3.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të siguroj zbatimin e rregullave gjatë proceseve të angazhimit të punëtorëve për shërbime të veçanta mos të kalojnë rregullat mbi gjashtë muaj dhe të bëj përpjekje që për pozitat e rregullta të punës, punëtorët të angazhohen përmes listës së pagave. Në anën tjetër të konsideroj që për periudhat e ushtrimit të pozitave më gjatë se tre muaj dhe që nuk ka pengesa ligjore të shpallë vendet e lira te punës duke i plotësuar ato pozita me punonjës të rregullt.			Nuk janë marrë masa.
3.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të siguroj që të behët një vlerësim real i nevojave të stafit nëpër departamente dhe ky numër të jetë i aprovuar sipas rregulloreve përkatësisht kërkesave buxhetore.		Në rregullore të organizimit të brendshëm të MMPH-së, zyra e ministrit ka staf nëntë (9) të punësuar, ndërsa në buxhet 20.	
3.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të siguroj një menaxhim më efikas në proceset e ardhshme të rekrutimit në mënyrë që të adresoj vonesat në fazat e ndryshme të procesit.	Po		
3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Ministri duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e planifikimit të të hyrave sipas njësive përkatëse dhe të sigurojë që planet buxhetore të të hyrave të bazohen në realizimet e mëparshme dhe përvojat e kaluara si dhe të kërkoj llogaridhënie efektive për nivelet e realizimit të tyre.		MMPH ka bërë një planifikim të të hyrave por menaxhimi i të hyrave është përcjellë me disa dobësi.	

3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Regjistrimet e renovimeve si pasuri të organizatës në objekte duhet të bëhen vetëm në ato objekte ku pronar legjitim është organizata financuese, në të kundërtën është i pamundur kapitalizimi i këtyre shpenzimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistroj si pasuri të ministrisë vetëm ato pasuri që në bazë të dokumenteve dëshmojnë se pasuria është në pronësi të OB, ndërsa për bashkëfinancimet që regjistrohen si investime në vijim të mbyllen në momentin kur objekti kompletohet dhe i dorëzohet përfituesit për shfrytëzim.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë që kërkesat për planifikime buxhetore të bëhen në përputhje me kërkesat për shpronësime, si dhe kompensimet të bëhen në mënyrë kronologjike bazuar në datën e aplikimeve dhe afateve kohore përkatëse. Po ashtu, Rekomandojmë Ministrinë që së bashku me Ministrin e Financave të shqyrtojnë mundësinë dhe potencialin e bartjes së buxhetit për shpronësime në Ministrinë e Financave aty ku vendoset buxheti dhe vlera e shpronësim. Kryerja e planifikimit të buxhetit, vlerësimi i pronave dhe procesimi i pagesave nga niveli i njëjtë i vendimmarrjes do të mund të evitonte pengesat ekzistuese gjatë procesit të shpronësimit. Midis të tjerash, do të mundësonte planifikimin më të saktë të buxhetit karshi nevojave reale si dhe do ti kontribuonte trajtimit të ankesave eventuale rreth vlerësimit të pronave.		MMPH ka ndërmarrë masa por ende mungojnë rezultatet e kërkuara.	
3.7.3 Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet lidhur me të dhënat e paraqitura në PVF janë duke funksionuar në mënyrë që informatat e shpalosura të jenë të sakta dhe të besueshme.	Po		